

Banka e Shqipërisë

2005

BULETINI
I BILANCIT TË PAGESAVE

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë.
Tel: 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks: 355-4-223558
e-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:
Sektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe
Komunikimit.
E-mail: public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 1200 kopje

P Ë R M B A J T J A

1.	<i>Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2005</i>	7
1.1	<i>Llogaria korente</i>	8
1.1.1	<i>Tregtia e jashtme në mallra</i>	9
1.1.2	<i>Shërbimet</i>	15
1.1.3	<i>Të ardhurat</i>	18
1.1.4	<i>Transfertat korente</i>	18
1.2	<i>Llogaria kapitale dhe financiare</i>	18
1.2.1	<i>Natyra dhe përbërja e flukseve të kapitalit</i>	19
1.3	<i>Rezervat valutore</i>	21
	<i>Aneks 1. Kursime, investime dhe bilanc korent</i>	22
	<i>Aneks 2. Tregtia me vendet e rajonit në kuadër të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë</i>	24
2.	<i>Analiza e rezultateve të vrojtimit të turizmit për vitin 2005</i>	26
2.1	<i>Metodologjia e vrojtimit</i>	26
2.2	<i>Analizë përshkruese e rezultateve</i>	27
2.3	<i>Ditëqëndrimi</i>	28
2.4	<i>Shpenzimet mesatare ditore</i>	29
	<i>Aneks metodologjik</i>	30
	<i>Shënime</i>	33
	<i>Aneks Statistikor</i>	34

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

1. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2005	
Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.	8
Tabelë 2. Tregtia e mallrave.	9
Tabelë 3. Eksporti sipas klasifikimit SITC.	10
Tabelë 4. Importi sipas klasifikimit SITC.	11
Tabelë 5. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.	14
Tabelë 6. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.	15
Tabelë 7. Ndryshimi vjetor i importit të mallrave dhe shërbimeve të transportit (në %).	16
Tabelë 8. Rritja vjetore e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve të udhëtimit (në %).	16
Aneks 1. Kursime, investime dhe bilanc korent	
Tabelë 1. Import-Eksport sipas vendeve dhe ndryshimi vjetor.	24
2. Analiza e rezultateve të vrojtimit të turizmit për vitin 2005	
Tabelë 1. Numri total i regjistruar në pikat kufitare të Shqipërisë.	27
Tabelë 2. Ndarja sipas mënyrës së udhëtimit për jorezidentët dhe rezidentët (në %).	28

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

1. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2005	
Grafik 1. Deficiti korent në përqindje ndaj PBB-së.	7
Grafik 2. Shpërndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve në llogarinë korente.	9
Grafik 3. Bilanci tregtar (në milionë euro).	10
Grafik 4. Rritjet e rritjes së eksporteve dhe importeve.	10
Grafik 5. Eksporti nga prodhimi i brendshëm (në milionë euro).	11
Grafik 6. Eksporti nga prodhimi i brendshëm sipas grupmallrave (në milionë euro).	11
Grafik 7. Kontributi i tregtisë nga përpunimi aktiv në vëllimin e përgjithshëm tregtar (importe+eksporte në milionë usd).	13
Grafik 8. Struktura e aktivitetit tregtar nga përpunimit aktiv.	13
Grafik 9. Vëllimi i tregtisë në shërbime ndaj PBB-së (në përqindje).	15
Grafik 10. Ecuria e eksportit të mallrave dhe e rritjes relative të eksportit udhëtime/mallra.	17
Grafik 11. Bilanci i të ardhurave (në milionë euro).	18
Grafik 12. Ecuria e dërgesave të emigrantëve (në milionë euro).	18
Grafik 13. Llogaria financiare në vite - fluksi neto në milionë euro.	19
Grafik 14. Deficiti korent dhe investimet e huaja direkte kundrejt PBB.	19
Grafik 15. Rezerva valutore në muaj importe.	21
Aneks 1. Kursime, investime dhe bilanc korent	
Grafik 1. Bilanci tregtar me vendet e rajonit.	24
Aneks 2. Tregtia me vendet e rajonit në kuadër të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë	
Grafik 2. Struktura e volumit tregtar me vendet e rajonit.	25
2. Analiza e rezultateve të vrojtimit të turizmit për vitin 2005	
Grafik 3. Fluksi i udhëtarëve rezidentë dhe jorezidentë sipas shteteve gjatë vitit 2005.	27
Grafik 4. Ndarja e të huajve dhe shqiptarëve sipas qëllimit të udhëtimit (në përqindje).	27
Grafik 5. Ditëqëndrimi mesatar i udhëtarëve sipas qëllimit të udhëtimit.	28
Grafik 6. Shpenzimet mesatare ditore të udhëtarëve sipas qëllimit.	29
Grafik 7. Struktura e shpenzimeve në të treja grupet e intervistuar.	29

Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.

	2004	2005	2004	2005
	në milionë euro		në % ndaj PBB-së	
Llogaria korente	(340.2)	(594.3)	(5.6)	(8.7)
Bilanci tregtar	(1,276.7)	(1,476.7)	(20.9)	(21.8)
Eksport	485.6	530.2	7.9	7.8
Import	(1,762.3)	(2,006.9)	(28.7)	(29.6)
Shërbime (neto)	(40.5)	(140.4)	(0.7)	(2.1)
Të ardhura (neto)	137.9	125.9	2.3	1.9
Transferta korente (neto)	839.1	896.9	13.7	13.2
Llogaria kapitale (neto)	413.3	424.0	6.8	6.3
Bilanci i përgjithshëm	233.7	124.8	3.8	1.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Deficitet e larta tregtare, në vite, janë financuar jo vetëm nga flukset hyrëse në kapitale, por mundësi të konsiderueshme financimi janë vërejtur brenda vetë llogarisë korente, përmes dërgesave nga emigrantët fakt që zvogëlon ndjeshëm rrezikun e financimit me anë të huamarrjes (shih aneksin 1). Gjatë vitit 2005, fluksi i transfertave korente hyrëse arriti në rreth 1 miliard euro, nga të cilat vlerësohet se 84 për qind janë kontribut i emigracionit shqiptar. Dërgesat e emigrantëve për vitin 2005, vlerësohen në 802 milionë euro ose në rreth 11.6 për qind të PBB-së.

Hyrjet neto të kapitalit regjistruan një nivel prej 424 milionë eurosh, duke mundësuar në masën 71.3 për qind financimin e deficitit korent. Ky import kapitali, gjithashtu, është reflektuar në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 125 milionë euro. Rezerva e autoritetit monetar në fund të vitit 2005 shënoi nivelin 1.204 miliardë euro, duke qenë e mjaftueshme për të përballuar rreth 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

1.1 LLOGARIA KORENTE

Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 17.7 për qind krahasuar me vitin 2004, me një vlerë prej 5.9 miliardë eurosh. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh jashtë ekonomisë së Shqipërisë. Rreth 38 për qind e të ardhurave korente kanë ardhur në formën e transfertave korente, ndërkohë që eksporti i shërbimeve dhe ai i mallrave kanë siguruar përkatësisht 36 për qind dhe 19.7 për qind të të ardhurave.

Deficiti korent, kundrejt një viti më parë, ka pësuar një rritje prej 75 për qind, rreth 594 milionë euro. Bilanci negativ ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, vlerësohet në rreth 30 për qind. Në rreth 58 për qind të totalit, importi gjatë këtij viti prezantohet në importe mallrash kapitalë dhe në importe mallrash të ndërmjetëm, ndërkohë që kërkesa e brendshme për mallra konsumi ka mbetur e lartë. Rritja e deficitit tregtar në mallra dhe në shërbime u balancua pjesërisht nga rritja e transfertave korente dhe e të ardhurave faktoriale neto.


Megjithëse, investimet private në kapitalin prodhues shoqërohen me rritje të kapaciteteve prodhuese për eksporte, një tipar i dallueshëm i ekonomisë mbetet niveli i ulët i eksporteve, kjo si pasojë e vonësive kohore dhe kërkesës së brendshme të paplotësuar akoma. Përgjatë vitit 2005, ato kanë përbërë mesatarisht rreth 7.8 për qind të PBB-së, duke përballuar financimin e vetëm rreth 26 për qind të vëllimit të importeve të ekonomisë.

Llogaria e shërbimeve gjatë vitit 2005 ka regjistruar rritje si në eksporte, ashtu edhe në importe. Në krahasim me vitin 2004, importet e shërbimeve janë rritur më shpejt se eksportet e kësaj kategorie, duke çuar në rritje deficitin e saj me rreth 100 milionë euro. Ndërkohë, bilanci pozitiv i transfertave dhe të ardhurave korente, vlerësohet në nivelet e vitit të kaluar.

1.1.1 TREGTIA E JASHTME NË MALLRA

Shkëmbimet tregtare në mallra vazhdojnë të zënë një pjesë të konsiderueshme në totalin e transaksioneve korente të vendit tonë me pjesën tjetër të botës. Me një vëllim të përgjithshëm prej 2.5 miliardë eurosh, ato përbëjnë 41 për qind të tyre gjatë këtij viti. Rritja vjetore prej 290 milionë eurosh ose 14 për qind, vlerësohet të jetë më e ulët se ajo e vitit të kaluar.

Grafik 2. Shpërndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve në llogarinë korente.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


	Njesia	2003	2004	2005
Eksporetet	mln euro	395.24	485.58	530.19
Importet	mln euro	1,638.08	1,830.51	2,083.85
Bilanci tregtar	mln euro	-1,242.84	-1,344.93	-1,553.66
Vëllimi tregtar	mln euro	2,033.32	2,316.09	2,614.04
Rritja e eksporteve (kundrejt vitit të mëparshëm)	%	13.4	22.9	9.2
Rritja e importeve (kundrejt vitit të mëparshëm)	%	4.4	11.7	13.8
Eksporetet/PBB	%	7.6	8.0	7.9
Importet/PBB	%	31.5	30.0	30.9
Bilanci tregtar/PBB	%	-23.9	-22.1	-23.0
Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet	%	24.1	26.5	25.4
Shkalla e hapjes ekonomike	%	39.1	38.0	38.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Tregtia e mallrave.


Ekonomia shqiptare për mëse një dekadë ka krijuar një profil të saj, i cili karakterizohet nga importet të larta në mallra. Këtë e tregon edhe fakti që gjatë këtij viti, importet përfaqësuan 80 për qind të vëllimit të tregtisë së jashtme. Importet e mallrave kanë vazhduar të ndjekin trendin rritës duke kapur shifrën e 2.1 miliardë eurove, me një rritje nominale prej 253 milionë euro ose 14

Grafik 3. Bilanci tregtar (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Ritmet e rritjes së eksporteve dhe importeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

për qind kundrejt vitit paraardhës. Eksporti i mallrave ka realizuar 530 milionë euro të ardhura ose 9 për qind më e lartë se ajo e vitit paraardhës. Nivele të ulta të kontributit të eksporteve në PBB regjistrohen edhe këtë vit, 7.9 për qind.

Deficiti tregtar vazhdoi të thellohej si në terma absolutë ashtu edhe në përqindje ndaj PBB-së, kjo në sajë të ngadalësimit të eksporteve si dhe zgjerimit të vazhdueshëm të importeve.

- Eksporti i mallrave

Në terma të konkureshmërisë së eksporteve, bizneset shqiptare përballesh me sfida reale për t'i bërë prodhimet e tyre të kërkuara në rajon edhe më gjerë.

Pjesa më e madhe eksportuese përbëhet nga mallrat e tekstileve, të veshjeve të këmbëve dhe metalet bazë. Gjatë vitit 2005 ritmet e rritjes së dy kategorive të para kanë qenë të ulta, duke bërë që në totalin e eksporteve pesha e tyre të bjerë. Eksporti i kategorisë "tekstile" vlerësohet rreth 30 për qind e totalit të eksporteve, kundrejt peshës mesatare 5-vjeçare prej 36 për qind.² Lulhatje modeste ka pësuar edhe pesha që zënë veshjet e këmbëve, nga 28 për qind në 27 për qind. Sjelljen më dinamike gjatë vitit 2005 e ka pasur eksporti i produkteve minerale dhe metaleve bazë, me një rritje vjetore përkatësisht 47 për qind dhe 17 për qind.

Tabelë 3. Eksporti sipas klasifikimit SITC.

Kodi	Përshkrimi	2003	2004	2005	2003	2004	2005	2005/2004
		Vlera në milionë euro			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	16.6	19.9	20.4	4.2	4.1	3.9	2.8
1	Pije dhe duhan	5.1	7.6	9.6	1.3	1.6	1.8	26.9
2	Materiale të papërpunuara	17.0	18.5	25.6	4.3	3.8	4.8	38.6
3	Lëndë djegëse	4.4	13.2	15.4	1.1	2.7	2.9	16.5
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	0.4	0.3	0.2	0.1	0.1	0.0	(13.6)
5	Produkte kimike	2.6	2.8	4.8	0.6	0.6	0.9	67.7
6	Mallra të përpunuar	68.4	97.3	114.3	17.3	20.0	21.6	17.5
7	Makineri dhe pajisje	14.0	19.1	22.1	3.6	3.9	4.2	16.0
8	Mallra të tjerë të përpunuar	266.9	307.0	317.7	67.5	63.2	59.9	3.5
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	-	-	-	-	-	-	
	TOTALI	395.2	485.6	530.2	100.0	100.0	100.0	9.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Pozitive kanë qenë zhvillimet e eksportit nga prodhimi i brendshëm, i cili ka rritur konsiderueshëm peshën që zë në totalin e eksporteve, nga 21 për qind në vitin 2004 në 30 për qind në vitin 2005, duke shfaqur kështu mundësi reale për zgjerim të mëtejshëm. Pjesa dërrmuese e eksportit nga prodhimi vendas zihet nga metalet bazë dhe mineralet, dhe më konkretisht giza dhe çeliku. Premtues është edhe zhvillimi i prodhimeve bujqësore të origjinuara nga Shqipëria, edhe pse hasen vështirësi në plotësimin e standardeve evropiane.

- Importi i mallrave

Importet e mallrave gjatë këtij viti u karakterizuan nga vëllime të larta si dhe nga një shpërndarje më proporcionale në grupmallra, krahasuar me eksportin. Ritmet e rritjes së tyre kapërcyen ndjeshëm ato të eksporteve, veçori kjo e ndryshme nga ajo e viteve të fundit. Dinamika e importeve ka qenë e ndryshme për grupmallra të ndryshëm.


Plotësimi i kërkesës së brendshme për produkte bujqësore nga prodhimi vendas bëri që importi i këtyre mallrave të pësonte një rritje modeste prej 3.3 për qind, ndërkohë që zhvillimi i industrisë në vend ka sjellë rritje në nevojën për këta mallra.

Grafik 5. Eksporti nga prodhimi i brendshëm (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Eksporti nga prodhimi i brendshëm sipas grupmallrave (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Importi sipas klasifikimit SITC.

Kodi	Përshkrimi	2003	2004	2005	2003	2004	2005	2005/2004
				Vlera në milionë euro		Struktura në %		Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	236.61	266.08	272.33	14.4	14.5	13.1	2.3
1	Pije dhe duhan	60.58	61.51	64.71	3.7	3.4	3.1	5.2
2	Materiale të papërpunuara	56.11	58.82	75.91	3.4	3.2	3.6	29.1
3	Lëndë djegëse	141.21	141.10	181.77	8.6	7.7	8.7	28.8
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	25.64	26.52	28.50	1.6	1.4	1.4	7.5
5	Produkte kimike	140.71	166.62	201.75	8.6	9.1	9.7	21.1
6	Mallra të përpunuar	388.09	427.48	509.85	23.7	23.4	24.5	19.3
7	Makineri dhe pajisje	356.04	431.49	488.97	21.7	23.6	23.5	13.3
8	Mallra të tjerë të përpunuar	233.08	250.90	260.07	14.2	13.7	12.5	3.7
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	-	-	-	-	-	-	
	TOTALI	1,638.08	1,830.51	2,083.85	100.0	100.0	100.0	13.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ashtu si në shumë vende të tjera të botës³ edhe në vendin tonë, është vënë re një prirje pozitive përsa i përket importit të prodhimeve farmaceutike. Ato janë

rritur me 28 për qind. Çmimi gjithnjë në rritje i naftës dhe i nënprodukteve të saj ka bërë që shpenzimet për lëndë djegëse të jenë rritur 28 për qind. Sjellje të tillë kanë pasur edhe materialet e papërpunuara dhe mineralet.

Kërkesa e sektorit privat për mallra kapitalë mbetet e lartë edhe pse theksojmë që ritmet e rritjes nuk kanë qenë të njëjta me ato që kanë karakterizuar vitet e fundit. Gjatë vitit 2005 ato u rritën me 16.5 për qind krahasuar me 39 për qind gjatë vitit 2004 (shih aneksin 5, tabela e klasifikimit të importeve sipas BEC).

Për t'u theksuar është edhe kriza që pësoi sektori energjistik gjatë vitit 2005, e cila përveç faktorëve të tjerë pati impaktin e saj në rritjen e importeve.

Boks 1. Përpilimi dhe analiza e importeve sipas BEC.



Tashmë, që prej vitit 2003 të dhënat e tregtisë së jashtme vijjnë të klasifikuara edhe sipas kategorive ekonomike (BEC), gjë që lejon studimin e këtyre statistikave në harmoni me komponentë të tjerë të statistikave të përgjithshme.

Edhe gjatë këtij viti ka mbizotëruar importi i mallrave të ndërmjetëm, të cilët përfaqësuan 45 për qind të totalit të importeve, por gjithësesi ato janë rritur me një përqindje më të ulët (16 për qind), krahasuar me vitin e kaluar (20 për qind). Impaktin më të madh

në këtë kategori e japin pajisjet dhe materialet industriale të përpunuara, të cilat gjatë vitit 2005 regjistruan një rritje prej 21 për qind.

	2003	2004	2005	2005/2004
	Struktura në %			Ndryshimi në %
Mallrat kapitalë	11.3%	12.8%	13.1%	16.5%
Mallrat e ndërmjetëm	46.6%	45.2%	45.5%	14.6%
Mallrat e konsumit	34.0%	32.9%	31.3%	8.5%
Të tjera	8.2%	9.1%	10.1%	25.4%

Vendi ynë vazhdon të mbetet importues, në vëllime të mëdha, i mallrave të konsumit edhe pse kjo kategori po humbet pikë në nivel përfaqësimi në favor të mallrave kapitalë, duke shërbyer kështu si indikator për investime të reja në aktivitetet prodhuese edhe ndërtuese të ekonomisë shqiptare. Konsiderueshëm është rritur edhe grupi "të tjera", rrjedhojë kjo e rritjes së importit të karburanteve dhe lubrifikanteve të përpunuara. Si pasojë e çmimeve gjithnjë e më të larta të këtyre mallrave, kjo rritje në vlerë është e amplifikuar dhe nuk shpreh rritje reale në vëllime.

Tregtia nga industria e përpunimit aktiv

Industria përpunuese (me material porositësi) në vendin tonë vazhdon të ketë pozicionin e saj dominues në aktivitetin tregtar.

Edhe pse ky aktivitet është karakterizuar nga një rritje e vazhdueshme gjatë viteve të fundit, viti 2005 shfaq një performancë të ndryshme. Situata në Shqipëri duket se u ndikua ndjeshëm nga zhvillimet ndërkombëtare. Epërsia e konkurrencës kineze në tregjet mbarëbotërore, shkaktoi tkurrjen e kësaj industrie edhe në vendin tonë.


Me një vëllim prej 677 milionë eurosh, tregtia nga industria e përpunimit aktiv në vend zuri rreth 26 për qind të transaksioneve tregtare të zhvilluara gjatë këtij viti, nivel më i ulët ky se ai i një viti më parë (29 për qind).

Suficiti tregtar, tregues i produktivitetit të kësaj industrie, këtë vit ka njohur nivele më të ulta si pasojë e rënies me 3.5 për qind të rieksporteve.

Riekспортet përfaqësuan 70 për qind të totalit të eksporteve, ndërkohë 15 për qind e impoorteve ishte lëndë e parë për përpunim të mëtejshëm.


Aktiviteti i kësaj industrie përfaqësohet kryesisht nga kompani me pjesëmarrje të kapitalit të vendeve partnere në tregti (Italia dhe Greqia) dhe të specializuara në prodhimin e artikujve tekstilë, të veshjeve të këmbëve dhe të metaleve.

Grafik 7. Kontributi i tregtisë nga përpunimi aktiv në vëllimin e përgjithshëm tregtar (importe+eksporte në milionë usd).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Struktura e aktivitetit tregtar nga përpunimit aktiv.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Boks 3. Ndikimi i Kinës në tregtinë e jashtme.

Më nënshkrimin e marrëveshjes për industrinë tekstilë në janar 2005, u krijuan mundësitë për vendet anëtare të OBT që të eksportojn pa kuota në tregjet evropiane dhe të Amerikës Veriore. Nga këto kushte të favorshme përfitoi Republika e Kinës për vetë përparësitë konkurruese të saj. Konkurrenca e fortë e mallrave kinezë krijoi një pështjellim dhe çoroditje në tregun evropian. Reagimi i BE që i menjëhershëm dhe në qershor të vitit 2005 u rivendosën përsëri kuotat për tekstilet, duke ndihmuar në zbutjen disi të pasojave që shkaktoi kjo rritje e menjëhershme e eksporteve kineze.

Ndikimet nga ky fenomen u ndjenë edhe në vendet e Ballkanit, të cilat përjetuan rënie të eksporteve të këtyre kategorive. Edhe Shqipëria ndjeu lëvizje në industrinë

përpunuese në vend. Më konkretisht eksportet e tekstileve dhe veshjeve të këmbëve, të cilat përfaqësonin 61 për qind të eksporteve tona gjatë vitit 2004, pësuan rënie në 57 për qind ndaj totalit. Por, pritet që këto efekte të jenë më të ndjeshme në një periudhë afatmesme, pasi kjo industri operon me material porositës të një viti më parë.

Në kahun e importeve Kina kapërceu Gjermaninë, duke u renditur e katërta ndër partnerët tregtarë të vendit tonë.

Shqipëria, ashtu si edhe vendet e tjera fqinje, ndodhet pothuajse në të njëjtat nivele për sa i përket avantazheve konkurruese si kostoja e lirë e punës, afërsia me BE, koha e shpejtë e dorëzimit të porosive, punime me porosi të vogla. Por ndërkohë ka në disavantazh të saj disa faktorë të tjerë si taksa të larta, specializim i ulët, nivel i lartë i korrupsionit sipas referencave ndërkombëtare, të cilat e bëjnë ambientin e biznesit në Shqipëri jo tepër të favorshëm.

- Tregtia sipas partnerëve tregtarë

Parë nga pikëpamja gjeografike, Shqipëria kryen 66 për qind të transaksioneve të saj tregtare me Bashkimin Evropian. Ndikimi më i madh është në eksporte, 88 për qind e të cilave janë të destinuara për këto vende, duke dëshmuar kështu edhe një herë shkallën e ulët të diversifikimit sipas partnerëve tregtarë.

Eksporti i prodhimeve shqiptare drejt këtyre tregjeve ka realizuar një rritje vjetore të ardhurash prej 30 milionë eurosh ose 7 për qind ndaj vitit të kaluar. Eksporti i vendit tonë me partnerët e BE është i përqëndruar, pothuajse totalisht, në industrinë me material porositësi. Gjatë vitit 2005 këto tregje janë tërhequr ndjeshëm nga zhvillimet e kësaj industrie përtej kontinentit Evropian. Kjo gjë ka sjellë efektet e saj në marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me Komunitetin Evropian, duke rezultuar në norma të ulta rritëse në eksporte ashtu edhe në importe.

Tabelë 5. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.

Eksporti	Pesha në eksporte			Ndryshimi vjetor	
	2003	2004	2005		%
Total	100	100	100		9.2
Vendet e BE-15	93.3	89.9	88.0		6.9
Itali	74.9	73.0	72.4		8.3
Greqi	12.8	12.0	10.5		-5.1
Gjermani	3.4	3.1	3.3		17.2
Vendet e Evropës Juglindore	4.0	8.5	9.2		19
Ish-Jugosllavi	0.6	0.4	0.8		143
Maqedoni	0.7	1.2	1.6		38
Kosovë	1.7	4.5	4.1		-1
Vende të tjera	2.7	1.6	2.7		86

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kuadër të liberalizimit rajonal, në vitin 2005 eksportet me vendet e rajonit, të përfshira në zonën e lirë tregtare (SEE-7), janë rritur 19 për qind

kundrejt një viti më parë, duke zgjeruar nivelet e përfaqësimit të këtyre vendeve nga 8.5 në 9.2 për qind. Kosova dhe Maqedonia përfaqësojnë tregun më të madh për eksporte të prodhimeve shqiptare.

Gjithashtu, gjatë këtyre dy viteve të fundit, interes për këto prodhime ka shfaqur edhe Turqia, që regjistroi një vlerë prej 9 milionë eurosh, duke u renditur e pesta në listën e vendeve partnere.

Importi	Pesha në importe			Ndryshimi vjetor %
	2003	2004	2005	
Total	100	100	100	13.8
Vendet e BE-15	78.2	65.0	60.4	5.7
Itali	38.1	32.6	29.3	2.4
Greqi	24.2	18.6	16.6	1.5
Gjermani	6.3	6.2	5.4	-0.9
Vendet e Evropës Juglindore	14.7	12.8	14.8	31.5
Bullgari	2.9	2.0	2.8	60.2
Bosnje-Hercegovinë	0.1	0.0	0.1	195.6
Kroaci	1.7	1.3	1.2	5.0
Serbi Mal i Zi	0.5	0.6	0.6	23.3
Maqedoni	1.0	1.0	1.2	35.0
Rumani	0.9	0.4	0.7	92.3
Turqi	7.5	7.1	7.5	19.4
Rusi	2.8	2.8	4.1	63.7
Ukrainë	2.5	2.5	2.9	31.6
Vende të tjera	7	22	25	27.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.


Ndryshe nga eksportet, gjeografia e importeve paraqitet më e larmishme. Ritmet e ulëta që kanë karakterizuar kërkesën për importe nga BE, kanë reflektuar një humbje në peshë nga 65 për qind në vitin 2004, në 60 për qind gjatë vitit 2005. Zhvillim të kundërt ka shfaqur importi nga partnerët rajonalë, i cili është rritur ndjeshëm me 32 për qind.

Dinamika e importeve ka sjellë një thellim të shpejtë të deficitit tregtar me vende si Kina, Turqia, Rusia e Ukraina.

1.1.2 SHËRBIMET

Tregtia e shërbimeve arriti vlerën 2 miliardë euro nga 1.6 miliardë në vitin 2004, duke zënë 1/3 e totalit të transaksioneve korente. Këto transaksione nga niveli prej 27 për qind i PBB-së në vitin 2004, vlerësohet të ketë arritur në 30 për qind të PBB-së në vitin 2005, duke theksuar prirjen pozitive të këtij treguesi ndaj PBB-së në vite.

Viti 2005 u mbyll me një deficit të lartë të llogarisë së shërbimeve prej 140 milionë eurosh, në krahasim



me deficitin prej 40 milionë eurosh në vitin 2004. Thellimi i tij ka ardhur si pasojë e deficiteve të larta në shërbimet e transportit, në ato kulturore dhe të biznesit si dhe shërbimet e tjera.

Ky fakt tregon rritjen e kërkesës së ekonomisë shqiptare për shërbime që është konkretizuar me një rritje vjetore prej 30 për qind. Në krahasim me vitin 2004, ku peshën kryesore vazhdojnë ta mbajnë eksporti i shërbimeve të turizmit dhe transportit.

- Shërbime transporti dhe sigurimi

Shërbimet e transportit, kanë ndjekur ecurinë e bilancit tregtar. Për vitin 2005, eksporti i shërbimeve të transportit është rritur më shpejt se importi, përkatësisht 30 për qind dhe 12 për qind kundrejt një viti më parë, si pasojë e rritjes së vëllimit tregtar.

Tabelë 7. Ndryshimi vjetor i importit të mallrave dhe shërbimeve të transportit (në %).

	2001	2002	2003	2004	2005
Importi i mallrave	27.1	6.2	0.4	11.3	13.9
Shërbime transporti (import)	17.0	13.3	2.4	18.1	12.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shërbimet e sigurimit kanë rezultuar me një bilanc negativ prej 20 milionë eurosh kundrejt 16 milionë eurove, të vlerësuar në vitin 2004. Eksportet e këtyre shërbimeve kanë rënë në masën 12 për qind në krahasim me një vit më parë. Kjo rënie lidhet kryesisht me uljen e tarifave të primit të sigurimeve në fillim të vitit 2005. Ndërkohë, krahu i importeve të shërbimeve të sigurimit është vlerësuar me rritje vjetore prej 18 për qind, e ndikuar nga rritja në vëllimin tregtar. Tregu shqiptar i sigurimeve vlerësohet si një treg në zhvillim. Gjatë vitit 2005, kompanitë e reja të sigurimit kanë krijuar lidhjet me partnerët ndërkombëtarë për të ndjekur politikat risiguruese. Këto politika, priten të rrisin gamën e prodhimeve të ofruara e rrjedhimisht, transaksionet e shërbimeve të sigurimit.

- Shërbime udhëtimi

Shërbimet e udhëtimit vazhdojnë të kryesojnë në transaksionet e shërbimeve me një peshë prej 65 për qind. Bilanci pozitiv i kësaj llogarie ka ardhur duke u ngushtuar në 56 milionë euro nga 75 milionë i vlerësuar një vit më parë, si rezultat i rritjes më të madhe të importit (23 për qind) ndaj eksportit (17 për qind) të shërbimeve të udhëtimit. Këto të ardhura neto kanë mundur të financojnë deri në masën 4 për qind deficitin tregtar, për vitin 2005.

Tabelë 8. Rritja vjetore e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve të udhëtimit (në %).

	T1/2005	T2/2005	T3/2005	T4/2005
Llogaria korente				
1. Mallra	8.7	22.5	15.1	15.5
1.1. Eksporti	11.3	10.3	10.0	5.3
1.2. Importi	9.5	18.8	13.7	13.0

2. Udhëtime	-80.4	409.4	-37.3	-5.1
2.1. Kredit	16.8	16.8	16.4	17.7
2.1.1. Biznes	1.7	10.4	-67.8	-75.8
2.1.2. Personale	29.1	21.5	81.7	108.0
2.2. Debit	42.0	7.8	26.4	21.0
2.1.1. Biznes	12.1	-3.7	-28.4	-67.4
2.1.2. Personale	58.9	13.9	49.6	70.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekonomia shqiptare ka regjistruar 692 milionë euro të ardhura nga eksporti i shërbimeve të udhëtimit ose 30 për qind më shumë se eksporti i mallrave. Historiku i fluksit të valutës së hyrë në Shqipëri, siç vërehet dhe në grafikonin 10, tregon për epërsi të eksportit të shërbimeve të udhëtimit ndaj eksportit të mallrave dhe një prirje të njëjtë edhe në të ardhmen.

Nga ana tjetër, shpenzimet janë vlerësuar në 635 milionë euro ose sa 79 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Këto vlerësime tregojnë për një fluks të lartë të udhëtarëve si dhe një rritje të koeficientëve të shpenzimeve mesatare ditore.⁴


Peshën më të madhe në këtë sektor e zënë shpenzimet e kryera për qëllime personale si për jorezidentët ashtu dhe për rezidentët. Gjatë vitit 2005, numri i udhëtarëve që kanë vizituar Shqipërinë është rritur në masën 16 për qind, në krahasim me vitin 2004, kryesisht për qëllime turistike me luhatje sezonale. Fluksi i vizitorëve vjen kryesisht nga Italia, Kosova dhe Greqia.

Numri i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë është rritur me 24 për qind në krahasim me një vit më parë. Rreth 70 për qind e totalit udhëtojnë jashtë për arsye personale, duke përmendur vizitat turistike, ato për qëllime mjekësore dhe arsimimin me destinacione kryesore vendet si Greqi, Itali dhe Kosovë.

- Shërbime të tjera

Kategoria “shërbime të tjera” ka regjistruar një deficit prej rreth 95 milionë eurosh, konsiderueshëm më i lartë se deficitin prej 15 milionë eurosh i një viti më parë. Gjatë vitit 2005, fluksi i të ardhurave të kësaj kategorie është vlerësuar 28 për qind më i lartë se një vit më parë. Ndërkohë, shpenzimet për këtë grup shërbimesh arritën në 264 milionë euro ose dy herë më të larta se në vitin 2004. Deficiti i kësaj kategorie ka ardhur si pasojë e deficitit të vërejtur në kategorinë e shërbimeve kulturore dhe të biznesit, prej 77 milionë eurosh. Fluksi më i lartë i shpenzimeve për këtë kategori është regjistruar në tremujorin e katërt të vitit 2005.

Grafik 10. Ecuria e eksportit të mallrave dhe e rritjes relative të eksportit udhëtime/mallra.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

e detyrimeve financiare se një vit me parë, konkretisht nga një rënie e fluksit të IHD-ve dhe huamarrjes.

Njëkohësisht më pak rritje pësuan edhe mjetet financiare të zotëruara nga rezidentët në formën e investimeve të portofolit dhe depozitave. Po gjatë këtij viti, vihet re një zhvendosje në formën e investimit nëpërmjet sistemit tonë bankar. Konkretisht, kanë rënë depozitat tona jashtë dhe janë rritur pretendimet financiare në sajë të huave afatmesme dhe afatshkurtra dhënë njësive jorezidente.

1.2.1 NATYRA DHE PËRBËRJA E FLUKSEVE TË KAPITALIT.

Flukset në llogarinë financiare ndahen midis të tre kategorive kryesore – investime direkte, investime portofoli dhe investime të tjera.

- Investimet direkte


Investimet e huaja direkte në Shqipëri edhe këtë vit, vlerësohen të jenë një burim i rëndësishëm për financimin e deficitit korent.

Gjithashtu, krahasuar me mundësitë e tjera të financimit, IHD-të edhe këtë vit mundësuan transferimin e teknologjisë dhe të përhapjes së njohurive, si dhe patën ndikim në hapjen e vendeve të reja të punës etj..

Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2005 arriti vlerën 213 milionë euro kundrejt 278 milionë eurove, realizuar në vitin e kaluar. Ky fluks pozitiv i investimeve ka ardhur kryesisht nga investimet në fushën e telekomunikacionit, nga rritja e investimeve të kompanive të shpimit të naftës si dhe nga rritja prej rreth 13 për qind e kërkesës për mallra kapitalë, makineri e pajisje. Rënia e investimeve të huaja direkte këtë vit (rreth 24 për qind kundrejt vitit të kaluar) ka ardhur si pasojë e mungesës së fenomenit të privatizimit, i cili në vitin 2004 ka funksionuar.


Megjithëse Shqipëria paraqet relativisht më pak kufizime ndaj veprimtarisë së investitorëve të huaj në krahasim me shtetet e tjera të Evropës Juglindore, ajo duket të ketë tërhequr më pak investime direkte në krahasim me vendet e rajonit.

Grafik 13. Llogaria financiare në vite - fluksi neto në milionë euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Deficiti korent dhe investimet e huaja direkte kundrejt PBB



Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Investimet e portofolit

Investimet e portofolit në bilancin shqiptar të pagesave është prezantuar në formën e mjeteve tona financiare (kryesisht të sistemit tonë bankar) në formën e bonove të thesarit të emetuar nga qeveri të huaja. Në fund të vitit 2005 stoku i investimeve të portofolit të ekonomisë shqiptare jashtë, u vlerësua 120 milionë euro.

Gjatë vitit 2005 këto investime u rritën me 2 milionë euro. Në tremujorët e parë dhe të tretë u vunë re luhatje, të cilat ishin pasojë e politikave investuese që ndjekin bankat e nivelit të dytë, me kalime nga investime portofoli në depozita dhe anasjelltas.

Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti mbizotërohen nga ato në usd, rreth 70 për qind, në euro 26 për qind dhe në stërlinën angleze 4 për qind.

- Investime të tjera

Detyrimet financiare në formën e depozitave të institucioneve jorezidente në sistemin tonë bankar, janë ulur me rreth 30 milionë euro. Në përbërjen e depozitave sipas monedhës, peshën më të madhe e zënë ato në monedhën evropiane euro me 67 për qind, e ndjekur nga dollari amerikan me 23 për qind dhe franga zviceriane me 9 për qind.

Detyrimet e ekonomisë shqiptare në formën e kredisë tregtare u rritën me rreth 8 milionë euro, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë. Megjithatë, këtë vit është lëvruar rreth 64 për qind më pak kredi tregtare se një vit më parë. Rritje e konsiderueshme prej 47 milionë eurosh u vu re në detyrimet e tjera valutore në formën e huave afatshkurtra dhe afatmesme, marrë nga njësitë jorezidente.

Gjatë vitit 2005, detyrimi i Shqipërisë i krijuar nga huamarrja u rrit me 139 milionë euro. Këtij detyrimi i shtohet edhe përdorimi i huave dhe i kredive nga FMN, prej 9.4 milionë eurosh. Ndërkohë, një zhvillim i viteve të fundit është pjesëmarrja e sektorit privat në aktivitetin huamarrës me bankat jashtë. Për vitin 2005, huamarrja private arriti në rreth 39 për qind të totalit, me një rritje vjetore prej 54 milionë eurosh, duke rritur kështu nivelin e përfaqësimit në totalin e borxhit të krijuar nga huamarrja.

Rritja e këtyre detyrimeve, e cila përbën 43 për qind të flukseve neto të llogarisë financiare, ka financuar kryesisht konsumin e ekonomisë, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për konsum si dhe ka financuar nevojat për kapital dhe/ose mallra kapitalë të kompanive.

Sipas shpërndarjes sektorale, peshën kryesore në huamarrjen shqiptare e zë huamarrja qeveritare dhe ajo shtetërore e garantuar, përkatësisht me 47 për qind dhe 14 për qind. Këto të marra së bashku, në fund të vitit 2005 u

rritën me 87 milionë euro. Shqipëria, deri në fund të vitit 2005, ka një borxh të jashtëm shtetëror prej 1.039 miliardë eurosh dhe borxh publik të garantuar prej 145 milionë eurosh.

Niveli i borxhit të krijuar nga huamarrja, si në terma absolutë ashtu edhe i vlerësuar ndaj PBB-së (mesatarisht për periudhën 2004-2005 vlerësohet në rreth 18 për qind). Ky borxh si stok detyrimesh për frymë, paraqitet relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit.

Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave mbizotërohet nga sdr (rreth 60 për qind) e ndjekur nga monedha evropiane euro (12 për qind), dollari amerikan (11 për qind) dhe monedha të tjera (17 për qind).


Pagesat e interesit dhe principalit (shërbimi i borxhit të jashtëm) të krijuar nga huamarrja nga jashtë vlerësohen në nivele modeste, duke arritur në rreth 4 për qind të totalit të eksporteve gjatë vitit 2005 ose shumë poshtë nivelit prej 25 për qind, të konsideruar përgjithësisht si nivel kritik. Arrihet në përfundimin se Shqipëria nuk është në prag të ballafaqimit me aftësi paguese të borxhit të jashtëm, të krijuar nga huamarrja.

Mjetet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 22 milionë euro ose rreth 6 herë më të ulta se një vit më parë. Ky ndryshim i mjeteve valutore ka ardhur nga kthimi e depozitave të sistemit tone bankar të mbajtura jashtë, të nevojshme për likuiditet për shkak të rritjes së kreditimit në vend. Në përbërjen e këtyre depozitave, 55 për qind e tyre janë në dollarë amerikanë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (40 për qind) dhe stërlina angleze (5 për qind).

Mbajtja e cash-it në valutë gjatë vitit 2005, ka shënuar një rritje prej 1.4 milionë eurosh dhe nuk ka shfaqur luhajtje domethënëse. Në përbërjen e saj në fund të vitit 2005, mjetet valutore cash në dollarë amerikanë zinin 29 për qind dhe ato në euro 66 për qind, stërlina angleze 4 për qind dhe franga zviceriane 1 për qind.

1.3 REZERVAT VALUTORE

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave të autoritetit monetar, me rreth 125 milionë euro. Në fund të vitit, këto rezerva regjistruan nivelin 1.204 miliardë euro, duke qenë të mjaftueshme për të mbuluar rreth 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.



ANEKS 1. KURSIME, INVESTIME DHE BILANC KORENT.

-PREZANTIMI I BILANCIT KORENT NË FLUKSE KAPITALI.

Llogaritë kombëtare, të cilat përdoren në vlerësimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ofrojnë një strukturë të dobishme në analizën e lidhjes ndërmjet bilancit korent dhe flukseve neto të kapitalit, si dhe në marrëdhënien e bilancit të pagesave me kursimet dhe investimet e brendshme.

Në të ardhurat e përgjithshme kombëtare, prodhimi kombëtar i përgjithshëm (PKP) trajtohet si shuma e të ardhurave të rrjedhura nga prodhimi i mallrave dhe i shërbimeve nën kategoritë: konsum privat (C), investime private (Ip), mallra dhe shërbime qeveritare (G) dhe eksporte (X). Importet (M) trajtohen si një zë negativ për të mënjeluar llogaritjen e dyfishtë të mallrave për konsum apo investime të blera në tregun e brendshëm, por të prodhuara jashtë.

Kështu,

$$\text{GNP} = C + I_p + G + (X - M),$$

ku, $X - M$ paraqet eksportin neto plus faktorin neto të të ardhurës*.

Një ekuacion i dytë i llogarive të të ardhurave kombëtare bazohet në specifikimin që çdo e ardhur e individëve ka katër mundësi përdorimi: konsum (C), kursim (S_p – kursim privat), taksa të paguara (T) apo të transferuara jashtë (Tr).

Duke qenë se PKP është shuma e të ardhurave të përfituara nga tërësia e individëve në një ekonomi, kemi:

$$\text{GNP} = C + S_p + T + Tr$$

Duke barazuar dy shprehjet e PKP të zhvilluara më sipër, përftojmë ekuacionin e mëposhtëm:

$$X - M - Tr = (S_p - I_p) + (T - G),$$

ku $X - M - Tr$ përfaqëson llogarinë korente.

Në këtë kuptim, llogaria korente është e barabartë me shumën e bilancit të kursim investimeve private dhe bilancit fiskal të qeverisë.

Kështu del qartë se një deficit buxhetor duhet patjetër të shoqërohet ose nga një bilanc pozitiv kursime investimesh ose nga një deficit korent. Në këtë kuadër, deficitet buxhetore të vazhdueshme do të reflektohen në përkeqësimin e vazhdueshëm të bilancit të llogarisë korente. Pra, politikat fiskale të ndjekura nga qeveria mund të ndikojnë në përkeqësimin apo anasjelltas, të pozicionit të jashtëm të vendit.

Për të shpjeguar lidhjen mes bilancit të llogarisë korente dhe flukseve të huaja neto ndjekim logjikën e mëposhtme: një mjet monetar i kursyer mund

të klasifikohet sipas tipeve të aktiveve që ai ble. Në veçanti, kursimet mund të përdoren për blerjen e kapitalit fizik të brendshëm, borxhit të qeverisë apo të mjeteve të huaja (FA) të llojeve të ndryshme. Duke patur parasysh që, borxhi i qeverisë është deficiti buxhetor (G-T) kemi,

$$S_p = I_p + (G - T) + FA$$

nga ku,


$$FA = (S_p - I_p) + (T - G) \text{ pra } FA = X - M$$

* Faktori neto i të ardhurës përfshin fitimet nga mjetet e brendshme dhe ato të huaja.

ANEKS 2. TREGTIA ME VENDET E RAJONIT NË KUADËR TË MARRËVESHJEVE TË TREGTISË SË LIRË

Tregtia me vendet e rajonit, me të cilat Shqipëria zbaton Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, paraqet në mënyrë domethënëse tendenca pozitive në drejtim të rritjes së shkëmbimeve tregtare, në përgjithësi.

Prej një periudhe trevjeçare tashmë, MTL i kanë dhënë shtysë marrëdhënieve tregtare ndërajonale dhe sidomos nxitjes së eksporteve, si një nga objektivat kryesorë të këtyre marrëveshjeve.



Rritja e theksuar e importeve nga këto vende gjatë vitit 2005, dy herë më shpejt sesa ajo e eksporteve, krijoi një raport import – eksport , 4 me 1 dhe për pasojë, një thellim të mëtejshëm të deficitit tregtar. Kjo ka sjellë shqetësim për ekonominë tonë dhe preokupim për të gjetur fusha dhe hapësira për rritjen e eksporteve.

Tregu shqiptar përse i përket treguesit të konkurrueshmërisë, futet në vendet me konkurrueshmëri të ulët, madje edhe në krahasim me vendet fqinje, të cilat nuk shquhen në këtë drejtim. Kjo ka shërbyer si pengesë për shfrytëzimin e lehtësive që sjellin MTL, për eksportimin e prodhimeve shqiptare në rajon. Megjithatë edhe pse në nivele të ulta, vlen për t'u theksuar se 87 për qind e këtyre prodhimeve janë eksport i mirëfilltë, pasi vijnë nga prodhimi i brendshëm.

Tabelë 1. Import-eksport sipas vendeve dhe ndryshimi vjetor.

	Import			Eksport		
	2004	2005	Ndryshimi në %	2004	2005	Ndryshimi në %
Bosnje Hercegovinë	0.91	2.70	196%	0.31	0.89	186.5%
Bullgari	36.94	59.18	60%	1.28	2.92	129.1%
Kroaci	23.80	24.99	5%	0.32	0.15	-53.6%
Kosovë	2.77	7.74	180%	22.07	21.89	-0.8%
Maqedoni	19.14	25.83	35%	6.04	8.33	38.0%
Moldavi	2.56	4.65	82%	0.00	0.00	1306.9%
Rumani	7.96	15.31	92%	0.18	1.28	604.6%
Serbi, Mal i Zi	10.67	13.16	23%	1.84	4.47	142.7%
Totali	104.75	153.56	47%	32.04	39.93	24.6%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregtia në rajon u karakterizua nga ndryshime të dukshme në shpërndarjen sipas partnerëve, e ardhur kjo si rezultat i kërkimit të tregjeve të reja më të favorshme. Në këtë këndvështrim, eksportet shqiptare kanë shfaqur tendenca më tepër drejt vendeve të tilla si Rumania, Serbi dhe Mali i Zi, e Bullgaria. Ndërkohë, me Kosovën gjatë këtij viti ato kanë ruajtur pothuajse të njëjtat nivele, dhe trendin pozitiv të tyre e kanë pasur edhe importet. Deficit i thellë

tregtar regjistrohet me të gjitha vendet, përjashtuar Kosovën, e cila përbën një rast unik për bilancin pozitiv tregtar.

Edhe pse vërehet një shpërndarje më proporcionale gjatë vitit 2005, Bullgaria e Maqedonia mbeten partnerët kryesorë të tregtisë sonë me vendet e rajonit (50 për qind të totalit të vëllimit tregtar), me një portofol më të shumëllojshëm prodhimesh krahasuar me vendet e tjera. Kroacia zë vendin e tretë përse i përket prodhimeve që ne importojmë (energji dhe gaz natyror). Por, shumë ndryshe paraqitet në kahun e eksporteve, ku MTL duket se nuk ka sjellë asnjë zhvillim pozitiv, madje ato janë përgjysmuar krahasuar me një vit më parë.

Struktura sipas grupmallrave vuan shkallën e ulët të diversifikimit, duke u përqëndruar me tepër në produkte si giza, çeliku dhe pijet alkolike. Eksportet e birrës, të destinuara kryesisht në Maqedoni e Kosovë, janë ulur ndjeshëm gjatë vitit 2005, rezultat kjo e kostos së lartë të këtij prodhimi krahasuar me ato të vendeve të rajonit. Hyrja së shpejti në fuqi e marrëveshjes me OBT, do të sjellë eliminimin e plotë të tarifave doganore për birrat e importit, duke i dhënë mundësinë këtij prodhimi të përballet me pozita të barabarta në tregjet e rajonit.

Përse përket bimëve mjeksore, bizneset shqiptare janë shumë më të përparuara në krahasim me konkurrentët rajonalë, si nga vëllimi ashtu edhe për eksportet e tyre.


Vendi ynë duhet të mendojë seriozisht për shfrytëzimin sa më të mirë të kësaj përparësie, pasi në Shqipëri rriten 30 për qind e llojeve të bimëve mjekësore të të gjithë Evropës.

Një tjetër prodhim shqiptar me potencial konkurrues, janë edhe vezët. Me treg të përqëndruar në Kosovë, gjatë vitit 2005 ato patën një rritje të ulët prej 8 për qind, e shkaktuar kjo nga infrastruktura e dobët si dhe nga alarmi i gripit të shpendëve.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, tregtia rajonale nuk është në nivelet e pritura dhe ka potenciale për më tepër. Në ecurinë e marrëveshjeve të tregtisë së lirë ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë, pasi ato janë të ndërthurura edhe me sistemin rregullator dhe reformat e ndërmarra në vendet përkatëse.

Marrëveshja unike për tregtinë e lirë, e cila pritet të hyjë në fuqi në vitin 2007, do të rrisë mundësitë reale, do të nxisë potenciale të reja në gjetjen e tregjeve si dhe do të krijojë perspektiva të qarta e të qëndrueshme në rajon, për të hyrë realisht në BE. Krijimi i këtij tregu kompakt pritet të japë efektet e tij për zhvillimin e biznesit, rritjen e konkurrencës, mundësi tërheqëse për investimet e huaja direkte etj..

Grafik 2. Struktura e vëllimit tregtar me vendet e rajonit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. ANALIZA E REZULTATEVE TË VROJTIMIT TË TURIZMIT PËR VITIN 2005

2.1 METODOLOGJIA E VROJTIMIT

Metodologjia është paraqitur sipas hapave në të cilët është kryer çdo fazë e vrojtimit që nga viti 1999.

Vrojtuesi-Banka e Shqipërisë.

Intervistuesi-Intervistuesi në terren, nën drejtimin e INSTAT.

Anketim-Intervistimi në terren.

a - Qëllimi i vrojtimit - Qëllimi i këtij vrojtimi është mbledhja e informacionit mbi ditëqëndrimin mesatar dhe shpenzimet mesatare ditore të turistëve rezidentë dhe jorezidentë, gjatë udhëtimeve të tyre përkatësisht jashtë dhe brenda Shqipërisë.

b - Përcaktimi i popullatës dhe i pikave të intervistimit - Popullata që synohet të mbulohet nëpërmjet këtij vrojtimi përbëhet nga dy grupe. Njëri është grupi i turistëve rezidentë (me kombësi shqiptare ose jo) që kthehen nga udhëtimi jashtë shtetit për qëllime turizmi; dhe tjetri është grupi i turistëve jorezidentë (me kombësi shqiptare ose jo), që largohen nga Shqipëria pas një udhëtimi turistik. Pikat në të cilat kryhet intervistimi janë kufijtë doganorë të Republikës së Shqipërisë. Duke shfrytëzuar të dhënat e Ministrisë së Rendit Publik mbi numrin e hyrje-daljeve në territorin e Republikës së Shqipërisë (të dhënat për vitin 2003), si dhe duke siguruar një përfaqësim në rreth 80 për qind të këtij fluksi, përcaktohen pikat për intervistim.

c - Zgjedhja e mostrës për intervistim - Zgjedhja e popullatës për vrojtim përcaktohet nisur nga regjistrimet e Ministrisë së Rendit Publik mbi fluksin e hyrje-daljeve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, për vitin 2003. Për përcaktimin e vëllimit të zgjedhjes (mostrës) për çdo pikë kufitare, kemi përdorur metodën e zgjedhjes tipike proporcionale, si mënyra më e përshtatshme për rastin tonë me të dhëna të grupuara.

d - Përpunimi i të dhënave - Hedhja dhe përpunimi i të dhënave realizohen pranë Bankës së Shqipërisë nga operatorë dhe nga specialistë të Zyrës së Bilancit të Pagesave. Para se të fillojë përpunimi, bëhet pastrimi i të dhënave nga vlerat ekstreme, konvertimi në euro i shumave të raportuara në monedha të ndryshme, si dhe konvertimi i muajve në ditë. Shpeshherë, përpunimi i të dhënave kombinohet me verifikimin e pyetësorëve të plotësuar, për të përcaktuar më mirë llojin e turistit dhe veçoritë e tij.

2.2 ANALIZË PËRSHKRUESE E REZULTATEVE

NUMRI I UDHËTARËVE

Numri i jorezidentëve, që kanë vizituar Shqipërinë, ka njohur një rritje vjetore prej 16 për qind gjatë vitit 2005, ndërkohë që fluksi i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë ka regjistruar një rritje prej 24 për qind. Në tabelën e mëposhtme është dhënë numri i regjistruar në pikat kufitare, për vitet 2003-2005.

	2003	2004	2005
Rezidentë që kanë dalë	1,350,399	1,693,867	2,096,806
Jorezidentë që kanë hyrë	558,057	645,409	747,837

Burimi: Ministria e Brendshme.

Tabelë 1. Numri total i regjistruar në pikat kufitare të Shqipërisë.


Rreth 75 për qind e fluksit hyrës ka ardhur kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian, ndërsa 20 për qind nga vendet e rajonit. Pjesa më e madhe e vizitorëve nga Bashkimi Evropian vijnë nga Italia (46 për qind) dhe Greqia (34 për qind), ndërsa rajoni përfaqësohet me shtetasit nga Kosova (46 për qind), Maqedonia (22 për qind), Turqia (16 për qind). Një vit më parë, vendet me numër udhëtarësh më të lartë ndaj totalit kanë qenë Italia dhe Greqia, ndërkohë për vitin 2005, peshën më të lartë e zënë Italia dhe Kosova.

Vihet re një rritje e fluksit hyrës në pikat kufitare Morinë dhe Qafë Thanë, pozicioni gjeografik i të cilave favorizon hyrjen në masë të vizitorëve nga Kosova dhe Maqedonia. Nisur nga ky fakt, me këtë ritëm rritjeje parashikohet që turizmi shqiptar të dominohet nga fluksi i kosovarëve.

Ndërkohë për rezidentët, larmia e vendeve drejt të cilave kanë udhëtuar është më e kufizuar, në varësi të mundësisë për t'u pajisur me vizë udhëtimi. Kështu, pavarësisht se Bashkimi Evropian përbën rreth 80 për qind të destinacioneve kryesore të rezidentëve, vendet më të frekuentuara mbeten Greqia (54 për qind) dhe Italia (34 për qind). Rreth 15 për qind e rezidentëve kanë udhëtuar drejt vendeve të rajonit, kryesisht në Kosovë (83 për qind), në Turqi (15 për qind) dhe Maqedoni (2 për qind).


Turizmi në Shqipëri karakterizohet nga sezonaliteti, duke ndikuar si në qëllimin e vizitorëve ashtu dhe në shpenzimet e kryera. Gjatë gjysmës së parë të vitit, 40-55 për qind e jorezidentëve kanë ardhur për qëllime biznesi ndërsa gjatë gjysmës së dytë të vitit, rreth 60-77 për qind kanë ardhur për pushime.

Grafik 3. Fluksi i udhëtarëve rezidentë dhe jorezidentë sipas shteteve gjatë vitit 2005.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Ndarja e të huajve dhe shqiptarëve sipas qëllimit të udhëtimit (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezidentët kanë udhëtuar jashtë kryesisht për qëllime personale gjatë gjithë vitit, duke patur një luhatje prej 70 -80 për qind ndaj numrit total të vrojtuar. Ndërkohë intervali 20-30 për qind përfaqëson rezidentët që kanë udhëtuar për qëllime biznesi.

Tabelë 2. Ndarja sipas mënyrës së udhëtimit për jorezidentët dhe rezidentët (në %).

	Jorezidentë (hyrje)			Rezidentë (dalje)		
	2003	2004	2005	2003	2004	2005
Me ajër	16	16	17	12	13	13
Me det	21	21	17	25	22	18
Me tokë	63	63	66	64	65	68


Burimi: Ministria e Brendshme.

Siç vihet re për të dyja grupet e udhëtarëve, mesatarisht 65 për qind udhëtojnë në rrugë tokësore, 20 për qind në rrugë detare dhe 15 për qind në rrugë ajrore. Mënyra e udhëtimit kushtëzohet nga kostoja e llojeve të transportit.

2.3 DITËQËNDRIMI

Ditëqëndrimi i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë ka ardhur duke u ulur për të dyja kategoritë. Për qëllime personale, qëndrimi luhatet tek 15 ditë, ndërsa për qëllime biznesi luhatja gjatë tremujorëve për vitin 2005 ka qenë në intervalin 2 deri 5 ditë, në krahasim me intervalin e një viti më parë prej 2 deri 7 ditësh.

Ndërkohë, për jorezidentët ka rezultuar me rënie ditëqëndrimi kundrejt një viti më parë (14 për qind për arsye personale dhe 35 për qind për biznes). Jorezidentët kanë qëndruar mesatarisht 8 ditë për biznes dhe 6 ditë për qëllime personale.



Emigrantët jorezidentë kanë qëndruar mesatarisht 12 ditë për qëllime personale dhe 4 ditë për qëllime biznesi, shifra e fundit luhatet në të njëjtat nivele me vitin e kaluar.

